

Formular për SYLLABUS të Lëndës

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	FAKULTETI I EDUKIMIT
Titulli i lëndës:	<i>BAZAT E SHKENCAVE NATYRORE ME METODOLOGJI</i>
Niveli:	Bachelor / Obligative - Fillor
Statusi lëndës:	Obliguar
Viti i studimeve:	Viti III, semestri i V
Numri i orëve në javë:	3+2
Vlera në kredi – ECTS:	7
Koha / lokacioni:	Fakulteti i Edukimit
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. dr. Zeqir Shaqiri
Detajet kontaktuese:	
Përshkrimi i lëndës	<p>Emërtimi i lëndës: <i>Bazat e shkencave natyrore me metodologji</i></p> <p>Përmbajtja: Kursi përmban një shumëllojshmëri të temave dhe nën temave që trajtojnë çështje nga: <i>Astronomia, Fizika, Kima</i>, synon përgatitjen e studentëve që t'i interpretojnë këto njohuri për nivelin e shkollës fillore. Në pjesën e parë të kursit ofrohen përmbajtje thelbësore nga astronomia me astrofizike, lënda dhe metoda e studimit në shkencat natyrore, madhësitë fizike dhe matja e tyre, lëvizjet mekanike, parimet e dinamikës, puna dhe energjia, hidrostatika, dukuritë termike, lëkundjet mekanike, valët dhe përhapja e tyre, zëri, dukuritë elektrike, rryma elektrike, dukuritë magnetike, optika, rrymimet ajrore, uji, ngrohja dhe ndotja globale, reshjet, erërat dhe moti, elementet kimike, përzierjet dhe tretësirat, alkoolet, alkaloidët, acidet nukleike, doza e rrezatimit dhe rreziku . Në pjesën e dytë ofrohen përmbajtje, aktivitete përkitazi me kompleksitetin e procesit të mësimdhënies së shkencave të natyrës.</p> <p>Në pjesën e tretë afrohet puna praktike dhe laboratorike</p>
Qëllimet e lëndës:	Në këtë kurs studentët do të fitojnë dituri të reja për shkencat natyrore dhe lidhjet e tyre në mes veti. Studentët do të shqyrtojnë edhe rolin e tyre si

	<p>mësimdhënës në drejtim të formimit të qëndrimit të drejtë të nxënësve ndaj ruajtjes së mjedisit jetësor, kursimit të energjisë si dhe të fitojnë shkathtësi jetësore e shprehi të punës. Institucionet arsimore, kërkojnë mësimdhënës me njohuri dhe aftësi të tilla që t'i përgjigjen kërkesave të kohës në rrafshin e mësimdhënies së shkencave të natyrës. Ky kurs ka për qëllim që të përgatisë studentët, që po ashtu të zbatojnë në planifikimin e punës mësimore metoda bashkëkohore të mësimdhënies në shkencat e natyrës.</p>
<p>Rezultatet e pritura të nxënies:</p>	<p>Rezultatet e të nxënit të lëndës: Pas përfundimit të këtij kursi (lënde) studentët do të jenë në gjendje të:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ zotërojnë konceptet kryesore që lidhen me rregullat, ligjet dhe parimet themelore të lëvizjeve të trupave qiellorë; ➤ shpjegojnë çështjet që kanë të bëjnë me lëvizjet mekanike, punën dhe energjinë, valët dhe përhapjen e tyre, lëkundjet mekanike, hidrostatikën, dukuritë termike, zërin, dukuritë magnetike, optiken, atomet dhe molekulat; ➤ zhvillojnë një kuptim të thellë dhe sistematik të çështjeve specifike, si p.sh: ngrohja dhe ndotja globale, reshjet, elementet kimike, alkoolet, ADN dhe ARN ➤ zotërojnë aftësitë për të përzgjedhur modele, metoda dhe instrumente për demonstrim në laborator; ➤ zotërojnë shkathtësi elementare zbatimin e aparatit matematikor në shkencat natyrore; ➤ identifikojnë aspektet e planifikimit të suksesshëm të mësimin në shkencat e

	natyrës; ➤ zbatojnë atë që parashihet në planifikimin e punës mësimore strategji të mësimdhënies bashkëkohore.		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë / javë	Gjithësej
Ligjërata	3	15	45
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	2	15	30
Kollokfieme, seminare	2	6	12
Detyra të shtëpisë	1	13	13
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	7	14
Përgatitja përfundimtare për provim	1	2	14
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	1	4	4
Projektet, prezantimet , etj	1	13	13
Totali			175 orë
Metodologjia e mësimdhënies:	Ligjerata interaktive, puna në grupe, punë individuale, punë në çifte, punë seminarike /projekte, ushtrime laboratorike, ushtrime numerike etj.		
Literatura			
Literatura bazë:	Shaqiri, Z.(2014). <i>Astronomi dhe astrofizikë</i> , Prishtinë. Shaqiri, Z.(2014). <i>Bazat e shkencave natyrore</i> . Prishtinë.		
Literatura shtesë:	<ul style="list-style-type: none"> • Bejtullahu, R.(2002). <i>Astronomia, kl. IV</i> . Prishtinë • Musai, B. (2008). <i>Mësimdhënia dhe të nxënit ndërveprues Biologji-Kimi (6-12)</i>. Tiranë: CDE • Musai, B. (2008). <i>Mësimdhënia dhe të nxënit ndërveprues Fizikë-Kimi (6-12)</i>. Tiranë: CDE • Musai, B. (2014). <i>Metodologji e mësimdhënies (Kapitulli i vlerësimit)</i>. Tiranë: CDE. 		

	<ul style="list-style-type: none"> • Hyseni, H., Shatri. B (2002). <i>Dituri natyre kl 3</i>, Libri shkollor, Prishtinë. • Hyseni, H., Shatri. B (2003). <i>Dituri natyre kl 4</i>, Libri shkollor, Prishtinë.
--	--

Plani i dizajnuar i mësimi:	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
<i>Java e parë:</i>	Njohja me syllabus Lënda dhe metodat e studimit në shkencat natyrore. Lidhmëria e shkencave natyrore me teknikën. Njohuritë e njerëzve në kohët e vjetra për dukuritë e ndryshme qiellore
<i>Java e dytë:</i>	Hyrje në astronomi dhe astrofizike. Astronomia sferike dhe praktike. Natyra fizike e trupave të Sistemit diellor.
<i>Java e tretë:</i>	Hëna dhe eksplorimi i saj. Ligjet e Keplerit, graviteti dhe shpejtësitë kozmike. Matja e largësive dhe e ndritshmërisë së yjeve. Spektrat dhe temperatura e yjeve.
<i>Java e katërt:</i>	Dielli dhe struktura e tij. Trupat e vegjël të Sistemit Diellor. Teoria e Ajnshtanit dhe universi. Eksplorimet dhe misionet
<i>Java e pestë:</i>	Puna praktike (Vrojtimit me dy teleskopë: reflektor dhe refraktor)
<i>Java e gjashtë:</i>	Madhësitë fizike dhe matja e tyre. Lëvizjet mekanike, Parimet e dinamikës. Puna dhe energjia.
<i>Java e shtatë:</i>	Hidrostatika e lëngjeve. Dukuritë termike.
<i>Java e tetë:</i>	Lëkundjet mekanike. Valët dhe përhapja e tyre. Zëri, Veshi. Dukuritë elektrike (elektrostatika). Rryma elektrike.
Vlerësimi i parë intermedier:	Testi
<i>Java e nëntë:</i>	Dukuritë magnetike. Fusha magnetike e tokës. Eksperimente dhe demonstrime.
<i>Java e dhjetë:</i>	Optika (drita, thjerra, pasqyra, syri, teleskopi, mikroskopi, syri).
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Sistemi periodik. Hidrogjeni. Heliumi. Azoti. Oksigjeni. Ozoni. Karboni. Dioksidi i karbonit. Metalet dhe jometalet.
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Ajri, Rrymimet ajrore. Uji rëndësia dhe ndotja e tij. Ngrohja dhe ndotja globale.
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Tretësirat, Lëndët e pastra dhe lëndët e përziera, Alkoolet, Droget (alkaloidet).
<i>Java e katërmbëdhjetë:</i>	Acidet nukleike (ADN, ARN). Doza e rrezatimit dhe rreziku.
Vlerësimi i dytë intermedier:	Testi
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Rrezatimi radioaktiv. Ndotja kimike dhe biologjike

Metodat e vlerësimit:

Vlerësimi mbështetet në këto aktivitete:

Pjesëmarrja	5%
Puna në orët e ushtrimeve (Projekti)	15 %
Testi 1	20 %
Testi 2	20 %
Provimi përfundimtar	40 %
Totali	100 %

Nota përfundimtare:

Pikët (%)	Nota
92-100	10
81-91	9
70-80	8
60-69	7
50-59	6

Përcaktimi i rregullave:

- Studentët janë të lirë të bëjnë pyetje, dhe të marrim pjesë në çdo aktivitet.
- Gjatë orëve mësimore nuk lejohen telefonat celularë.
- Nuk lejohet ardhja me vonesë apo largimi nga ora pa arsye.
- Studenti merr nënshkrim nga lënda, Bazat e shkencave natyrore me metodologji, kur vijueshmëria është së paku 80% nga numri i përgjithshëm i orëve të planifikuara për semestër.

Materiale nga web-site:

<http://www.sciencekids.co.nz/>

<http://www.csun.edu/science/physics/>

<http://www.physicslessons.com/demos.html>

<http://school.familyeducation.com/astronomy/solar-system/70021.html>

http://www.primaryscience.ie/activities_planet_profiles.php